

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E ENJTE 24 MARS 2022

Të nderuar deputet dhe qytetarë që po na ndiqni,

Projektligji “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për vitin 2022-2026”, në gjykimin tim, duhej të ishte paraqitur për diskutim dhe për dhënie mendimi në Komisionin e Ligjeve, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut, pasi do të ndihmonte në konsultimin më të gjerë të këtij projektligji. Kjo çështje hap, gjithashtu, debatin se si qeveria mund t’i përdorë të dhënat dhe statistikën në dobi të politikave për qytetarët apo i trajton ato si numra, shifra duke i lënë njerëzit në fatin e tyre. Le të vijmë konkretisht: sipas të dhënave zyrtare, Shkodra shënon 2 vjetët e fundit rritjen më të madhe të papunësisë me rreth 8% dhe, po ashtu, është në 3 vendet e para në 12 qarqet e vendit për falimentimin dhe mbylljen e bizneseve.

Mungesa e besimit, varfëria, papunësia, mungesa e rendit publik, lufta e grupeve kriminale, ka bërë që të largohen në emigracion rreth 20% e banorëve, duke e renditur Shkodrën të parën në vend për plagën e emigrimit. Si qytetarë e Shkodrës, vlerësoj nga ky Kuvend të gjithë të rinjtë, të rejtat, pjesëtarë të shoqërisë civile, qytetarët që protestuan kundër rritjes dramatike të çmimeve. Qeveria edhe një herë na dëshmoi se është shumë larg komuniteteve dhe gjithnjë e më shumë pranë klientëve të saj. Argumenti i qeverisë se nuk kontrollon dot tregun është një mashtrim i madh. Ishte po kjo qeveri dhe kjo parti që gjatë procesit zgjedhor të deformuar një vit më parë nxorën në rrugë të gjitha të dhënat familjare të shqiptarëve, madje edhe bindjet politike një për një. Ishte kjo qeveri, së cilës i dolën publikisht të gjitha të dhënat e pagave të qytetarëve, duke cenuar sigurinë dhe të drejtat e tyre.

Gjatë pandemisë, gjithashtu, megafoni i Kryeministrit dhe i qeverisë depërtoi në të gjitha familjet dhe në jetët e secilit, duke kufizuar lëvizjet tona, madje edhe me tanke e ushtri. Së fundi, qeveria u trokiti banorëve të këtij vendi shtëpi më shtëpi, duke shpërndarë formularë me pyetje për legalizimin e hashashit. E pra, të nderuar qytetarë, Kryeministri dhe qeveria e tij për gjithçka mund të ndërhyjë pa na pyetur ne, por për çmimet e tregut dhe ndaljen e abuzimeve nuk mund të veprojnë. Në asnjë vend të rajonit nuk ndodhi një abuzim i tillë, as në Malin e Zi, as në Kosovë, as në Maqedoninë e Veriut, në vendet tona fqinje, të cilat kanë pagat mesatare më të larta sesa ne, edhe pensionet, gjithashtu, më të larta sesa ne.

Sa për bordin, ishte zgjedhja me qesharake për të justifikuar mashtrimin dhe korrupsionin e qeverisjes. Për shkak të rritjes së çmimit të karburanteve dy ditë më parë besimtarë të shumtë, gra, burra bashkë me fëmijët e tyre morën rrugën me tren nga Shkodra në Laç dhe kjo duhet të kthehet në normalitet. Të gjithë udhëtarët, që zgjedhin trenin si mjet transporti, u përballen me kushte vërtet të vështira, me xhama të thyer, dyer të prishura, sedilje të amortizuara, pa asnjë kusht minimal të higjienës, pamjet e vagonëve duken si në Afganistan apo Pakistan; nuk ka asnjë investim minimal për të pasur disa vagonë të nivelit mesatar. Shkodra dhe Veriu nuk e meritojnë këtë.

Së fundi, këtij vendi i duhet të përballet me një tjetër krizë: atë të energjetikës dhe jo për shkak të natyrës, por për shkak të keqmenaxhimit. Sipas të dhënave, kuotat e liqenit të Fierzës kanë rënë nën 259 metra. Pra, 6 metra nga pika e vdekjes. Pse ka shkuar në këtë pikë rezerva hidrike, kur në qershor të vitit të kaluar rezervat ishin në kuotën maksimale plot 296,4 metra? Çfarë ka ndodhur që Shqipëria është në pikën e rrezikut të sigurisë energjetike? Qeveria duhet të përgjigjet dhe SPAK-u duhet të hetojë! Faleminderit!